

20040661214

L I G J I PËR BIBLIOTEKAT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kryerja e veprimtarisë së bibliotekave, puna e bibliotekave, themelimi, llojet e bibliotekave, organizimi, koordinimi, titujt profesionalë, mbikëqyrja dhe çështje tjera me rëndësi për kryerjen e veprimtarisë së bibliotekave në Republikën e Maqedonisë.

Materiali bibliotekar

Neni 2

(1) Material bibliotekar janë publikimet e botuara të shtypura dhe publikimet elektronike, bartësit e tonit, përkatësisht të tonit dhe fotografisë dhe publikime tjera të shumëzuara më ndryshe, si: libra, broshura, gazeta, revista, disertacione doktoranture, punime magjistrature, skripta, dorëshkrime, katalogje, prospekte, pllakate, afişe, programe, material kartografik dhe note, riprodhime të veprave artistike, panorama, kalendarë, fotografi dhe vepra tjera të përpunuara në teknikë të ngjashme me atë fotografike, programe kompjuterike, bartës të tonit dhe të tonit dhe fotografisë (pllaka magnetofoni, kaseta audio dhe video, kompakt disqe, materiale magnetofonike, magnetike dhe materiale tjera, CD-Rome dhe ngjashëm), diapozitivë, mikrofilma, mikrofishe, material informativ të krijuar me teknikë riprografike në çfarëdo qoftë mënyre dhe forme, baza elektronike të të dhënave dhe publikimeve tjera.

(2) Materiali bibliotekar, i cili është përcaktuar si e mirë bibliotekare në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe materiali i rrallë bibliotekar i përcaktuar me aktin e përgjithshëm të ministrit, i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i kulturës (në tekstin e mëtejme: ministri), gjenden nën regjim të veçantë juridik të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

(3) Materiali bibliotekar dhe e mira materiale përbëjnë fondin bibliotekar të bibliotekës.

II. LLOJET E BIBLIOTEKAVE, THEMELIMI DHE NDËRPRERJA ME PUNË

Biblioteka

Neni 3

(1) Biblioteka është institucion joprofitabil nga lëmi i kulturës, e cila në pajtim me parimet profesionale mban fonde bibliotekare, burime të informatave dhe siguron qasje dhe shfrytëzimin e të njëjtave, siguron burime të huazimit ndërbibliotekar, si dhe shërbime të burimeve të huaja të informimit.

(2) Biblioteka në kuptim të këtij ligji bën furnizimin, ruajtjen, hulumtimin, grumbullimin, rregullimin, përpunimin profesional dhe shkencor, studimin dhe dhënien në shfrytëzim të materialit bibliotekar, si dhe mbledhjen, përpunimin dhe prezentimin e informatave dhe të dhënave për materialin bibliotekar (në tekstin e mëtejme: veprimtari bibliotekare).

(3) Biblioteka është e hapur për opinionin dhe nëpërmjet shfrytëzimit të materialit bibliotekar përhap arsimin dhe përherë i kënaq nevojat kulturore dhe nevojat tjera të opinionit më të gjerë, kontribon për përparimin e punës profesionale dhe shkencore-hulumtuese, si dhe zhvillon komunikim interaktiv me shfrytëzuesit për shkak të shfrytëzimit dhe popullarizimit të publikimeve dhe materialit tjetër informativ.

Veprimtari bibliotekare

Neni 4

- (1) Veprimtaria bibliotekare është veprimtari me interes publik.
- (2) Veprimtari bibliotekare, sipas dispozitave të këtij ligji kryejnë bibliotekat.
- (3) Veprimtari bibliotekare mund të kryejnë edhe persona tjerë juridikë, nëse janë regjistruar për kryerjen e veprimtarisë bibliotekare dhe të njëjtën e kryejnë në pjesë të organizuar në mënyrë të veçantë, në kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër si bibliotekë në përbërje.

Zbatimi i dispozitave tjera

Neni 5

- (1) Për themelimin, punën dhe ndërprerjen e bibliotekave, udhëheqjen, administrimin, vendosjen, financimin dhe mbikëqyrjen administrative, zbatohen dispozitat e Ligjit për kulturë, nëse me këtë ligj ose me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.
- (2) Mbrojtja e të mirës bibliotekare kryhet në pajtim me këtë ligj dhe ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Lloje bibliotekash sipas themeluesit

Neni 6

- (1) Bibliotekat sipas themeluesit, mund të jenë publike (nacionale dhe lokale) dhe private.
- (2) Bibliotekë nacionale mund të themelojë Qeveria e Republikës së Maqedonisë, kurse bibliotekë lokale mund të themelojnë komnatat, Qyteti i Shkupit dhe komnatat në Qytetin e Shkupit.
- (3) Bibliotekë private mund të themelojë personi juridik dhe fizik i vendit dhe i huaj, në kushte dhe mënyrën e përcaktuar me këtë ligj dhe ligj tjetër.
- (4) Bibliotekat në përbërjen e vet mund të kenë edhe njësi organizative, të cilat gjenden jashtë selisë së bibliotekës. Bibliotekat mund ta kryejnë veprimtarinë e vet edhe jashtë selisë së vet ose në lokale afariste nëpërmjet bibliotekave lëvizëse.

Lloje bibliotekash sipas lëndës së punës

Neni 7

- (1) Boibibliotekat, sipas lëndës së punës së vet mund të jenë të përgjithshme dhe të specializuara.
- (2) Të përgjithshme janë bibliotekat, veprimtaria tematike e të cilave është e destinuar për kënaqjen e nevojave të përgjithshme arsimore, kulturore dhe nevojave tjera të qytetarëve.
- (3) Të specializuara janë bibliotekat, veprimtaria tematike e të cilave është e destinuar për kënaqjen e nevojave për punë profesionale dhe shkencore-hulumtuese, si dhe për nevojat e grupeve të ndryshme qëllimore të shfytëzuesve, si biblioteka shkollore, univerzitare, profesionale dhe biblioteka tjera.
- (4) Lloji i bibliotekës, varësisht nga funksioni, përcaktohet me aktin e themelimit të saj.

Kushte të veçanta për fillimin me punë të bibliotekës

Neni 8

- (1) Biblioteka, në pajtim me ligjin, mund të fillojë me punë nëse i plotëson kushtet e posaçme vijuese:
 - 1) të jenë siguruar mjete themelore për fillimin me punë;
 - 2) të jenë siguruar mjete financiare për kryerje të qëndrueshme të veprimtarisë;
 - 3) të ekzistojë elaborat për themelimin e bibliotekës;
 - 4) të jenë siguruar lokale dhe pajisje për ruajtjen dhe shfrytëzimin e fondit bibliotekar;
 - 5) të jetë siguruar materiali bibliotekar; dhe
 - 6) të ketë kuadër të punësuar profesional përkatës.

(2) Për plotësimin e kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni, ministri merr vendim me marrjen e mendimit paraprak nga biblioteka amë.

(3) Kundër vendimit nga paragrafi (2) i këtij neni mund të ushtrohet ankesë në Komisionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Ankesa nuk e shtynë vendimin.

(4) Standardet për përcaktimin e llojeve të bibliotekave, për punën e tyre, për vendosjen dhe për ruajtjen e materialit bibliotekar dhe dokumentacionin bibliotekar, i përshkruan ministri.

Vlerësimi i punës së bibliotekës

Neni 9

Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i kulturës (në tekstin e mëtejme: Ministria) në çdo pesë vjet nga dita e marrjes së vendimit për plotësimin e kushteve për punën e bibliotekës detyrimisht kryen vlerësimin e plotësimit të kushteve për punë të bibliotekës.

Ndërprerja me punë e bibliotekës

Neni 10

(1) Biblioteka mund të ndërpresë me punë nëse nuk i plotëson kushtet e veçanta për fillimin me punë.

(2) Themeluesi vendos për ndërprerjen e bibliotekës, nëse biblioteka nuk e kryen veprimtarinë ose ndërpritet interesi për realizimin e të cilit është formuar.

(3) Në rast të ndërprerjes me punë të bibliotekës publike, vendimi për ndërprerjen e bibliotekës doemos duhet të përmbajë edhe dispizita për mbrojtjen dhe vendosjen e materialit bibliotekar dhe të dokumentacionit bibliotekar në bibliotekë tjetër publike përkatëse.

(4) Nëse Ministria gjatë vlerësimit për plotësimin e kushteve për punë nga neni 9 i këtij ligji vërteton se biblioteka nuk i plotëson kushtet nga neni 8 i këtij ligji, ministri pas mendimit të marrë paraprakisht nga biblioteka amë, merr vendim me të cilin ndërpritet të vlejë vendimi për plotësimin e kushteve për fillimin me punë të bibliotekës.

(5) Para marrjes së vendimit nga paragrafi (4) i këtij neni, ministri me vendim përcakton afat në të cilin biblioteka duhet t'i plotësojë kushtet nga neni 8 i këtij Ligji.

(6) Kundër vendimit nga paragrafi (4) dhe (5) i këtij neni mund të ushtrohet ankesë në Komisionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Ankesa nuk e shtynë vendimin.

III. THEMELIMI, UDHËHEQJA, ADMINISTRIMI DHE FINANCIMI I BIBLIOTEKAVE LOKALE DHE PRIVATE

Themelimi i bibliotekave lokale

Neni 11

(1) Këshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në Qytetin e Shkupit, merr vendim për themelimin e bibliotekës lokale, sipas kushteve dhe standardeve të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Biblioteka lokale ka statutin me të cilin rregullohet puna dhe organizimi i bibliotekës, emri, selia, lënda e punës dhe çështje tjera që janë me rëndësi për punën e bibliotekës të përcaktuar me këtë ligj ose me ligj tjetër.

(3) Këshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në Qytetin e Shkupit jep pëlqim për statutin.

Udhëheqja me bibliotekat lokale

Neni 12

(1) Organ i udhëheqjes me bibliotekën lokale është drejtori.

(2) Prefekti e zgjedh dhe e shkarkon drejtorin e bibliotekës.

(3) Drejtori i bibliotekës zgjedhet me konkurs publik, i cili botohet në mjetet e informimit publik më së voni tre muaj para kalimit të mandatit të drejtorit paraprak. Konkursin e shpallë prefekti.

(4) Kandidatët ia paraqesin dokumentet e nevojshme në pajtim me konkursin, këshillit drejtues të bibliotekës. Kandidatët për drejtor detyrimisht paraqesin propozimprogramin e vet për zhvillimin e institucionit.

(5) Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni treanëtarësh i formuar nga Këshilli drejtues i bibliotekës. Komisioni është i obliguar që në afat prej pesë ditësh nga përfundimi i konkursit t'i shqyrtojë dokumentet e paraqitura.

(6) Komisioni ia paraqet prefektit propozimin e kandidatëve.

(7) Prefekti, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së propozimit, bën zgjedhjen e drejtorit.

(8) Drejtori zgjedhet me mandat prej katër vjetësh.

(9) Kandidatët që nuk janë zgjedhur, në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së vendimit të prefektit, kanë të drejtë për ankese lidhur me zbatimin e procedurës për zgjedhjen e drejtorit në Komisionin e shkallës së dytë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zgjidhjen e çështjeve nga lëmi i marrëdhënieve të punës.

(10) Kundër vendimit të komisionit nga paragrafi (9) i këtij neni, kandidati ka të drejtë për ankesë në gjykatën themelore kompetente.

(11) Kushtet e veçanta për zgjedhjen e drejtorit dhe procedura përcaktohen me statutin e bibliotekës.

(12) Në rastin kur nuk është zgjedhur drejtori i bibliotekës ose para kohe i ka kaluar mandati, prefekti menjëherë emëron ushtrues detyre drejtor, pa konkurs nga radhët e të punësuarve. Ushtruesi i detyrës drejtor emërohet për kohën deri në zgjedhjen e drejtorit të bibliotekës, kurse më së shumti për gjashtë muaj.

(13) Ushtruesi i detyrës drejtor i ka të gjitha të drejtat dhe obligimet e drejtorit të bibliotekës.

Administrimi me bibliotekën lokale

Neni 13

(1) Organ i administrimit të bibliotekës lokale është këshilli drejtues.

(2) Këshillin drejtues e përbëjnë pesë përfaqësues, të cilët i emëron Këshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në Qytetin e Shkupit, prej të cilëve tre janë përfaqësues nga radhët e individëve nga lëmi i kulturës dhe dy përfaqësues nga radhët e të punësuarve në bibliotekë, persona profesionalë dhe kompetentë.

(3) Këshilli drejtues i bibliotekës miraton statutin e bibliotekës, përcakton politikën dhe parimet për zhvillimin e bibliotekës, propozon programin vjetor për punë të bibliotekës dhe kryen punë tjera të përcaktuara me aktin për themelim dhe me statut.

(4) Çështjet tjera lidhur me punën e këshillit drejtues rregullohen me statutin e bibliotekës.

Financimi i bibliotekave lokale

Neni 14

(1) Mjetet për financimin e veprimtarisë së bibliotekave lokale sigurohen në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me ligj.

(2) Biblioteka u dërgon për miratim Këshillit të komunave, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit, programin vjetor për punë, raportin për punë dhe planin financiar.

Themelimi i bibliotekave private

Neni 15

(1) Bibliotekë private mund të themelojë personi juridik dhe fizik i vendit dhe i huaj, në kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër.

(2) Fondin bibliotekar të bibliotekës private mund ta përbëjë vetëm materiali bibliotekar.

(3) Fondi bibliotekar i bibliotekës private merr statusin e të mirës së mbrojtur, nëse në procedurë të përcaktuar me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore për të njëjtën miratohet akt përkatës për mbrojtje.

(4) Në rastet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni të punës së bibliotekave private zbatohen dispozitat, të cilat vlejnë për pronarët e të mirave të mbrojtura, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

IV. PUNA E BIBLIOTEKAVE

Puna e bibliotekave

Neni 16

(1) Bibliotekat i kryejnë posaçërisht punët vijuese:

1) furnizojnë, hulumtojnë, grumbullojnë, përpunojnë dhe studiojnë profesionalisht, mbrojnë, ruajnë, botojnë, informojnë, prezantojnë dhe japin në shfrytëzim material bibliotekar.

2) promovojnë dhe afirmojnë fondin bibliotekar të Republikës së Maqedonisë nëpërmjet ekspozitave, ligjëratave, leximeve letrare, seminarëve dhe kurseve, shfaqjes së filmave dhe formave tjera të veprimit;

3) sigurojnë kushte për shfrytëzim dhe për studim shkencor dhe profesional të fondit bibliotekar;

4) botojnë publikime shkencore, katalogje, udhërfyese dhe material tjetër informativ;

5) mbajnë evidencën e hyrjes, librin e inventarit, katalogun themelor dhe lloj tjetër evidence dhe dokumentacioni;

6) mbajnë katalogje dhe kartoteka bibliotekare;

7) bëjnë përpunim profesional dhe ruajtje të materialit bibliotekar me vlerë lokale;

8) kryejnë veprimtari bibliografike-informative dhe dokumentuese;

9) kryejnë huazimin dhe shkëmbimin e materialit bibliotekar me biblioteka tjera dhe me institucione të ngjashme;

10) kujdesen për zbatimin e drejtë të masave teknike-mbrojtëse për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e materialit bibliotekar;

11) marrin pjesë në mirëmbajtjen e bazës nacionale reciproke bibliografike të katalogjeve qendrore dhe bazës së të dhënave, dhe

12) kryejnë edhe punë tjera nga lëmi i veprimtarisë bibliotekare, në pajtim me ligjin.

(2) Bibliotekat mund të bëjnë shitjen e materialit të antikitetit bibliotekar në kushte të cilat do t'i përcaktojë biblioteka amë.

(3) Punët nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, bibliotekat i kryejnë për rajonin në të cilin janë themeluar.

Biblioteka amë

Neni 17

Për shkak të përparimit dhe koordinimit të punës së bibliotekave në territorin e Republikës së Maqedonisë, me këtë ligj dhe me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si bibliotekë nacioale qendrore me funksion amë përcaktohet Institucioni nacional “Biblioteka nacionale dhe universitare “Shën Kliment Ohridski” – Shkup (në tekstin e mëtejme: biblioteka amë).

Puna e bibliotekës amë

Neni 18

Biblioteka amë, përveç punëve nga neni 16 i këtij ligji, i kryen edhe punët vijuese:

1) studion gjendjen dhe kushtet për zhvillimin e rrjetit bibliotekar, organizimin dhe përparimin e veprimtarisë bibliotekare dhe jep mendime dhe propozime profesionale;

- 2) koordinon punën e bibliotekave në Republikën e Maqedonisë;
- 3) grumbullon, koordinon dhe mundëson qasje te materiali bibliotekar, i cili i dedikohet Maqedonisë, i botuar kudo qoftë në botë;
- 4) u ofron ndihmë profesionale bibliotekave në Republikën e Maqedonisë;
- 5) jep iniciativa për nxjerrjen e dispozitave dhe masave për përparimin e veprimtarisë bibliotekare dhe përsosjen profesionale të kuadrove bibliotekare;
- 6) përpunon dhe boton bibliografi vijuese dhe retrospektive në Republikën e Maqedonisë dhe bibliografi tjera të veçanta;
- 7) përgatit udhëzime për përpunimin profesional dhe ruajtjen e materialit bibliotekar të vendlindjes me rëndësi nacionale;
- 8) bën stërvitjen dhe edukimin e kuadrit bibliotekar në Republikën e Maqedonisë nëpërmjet qendrës edukative;
- 9) organizon bashkëpunim ndërmjet bibliotekave, veçanërisht në furnizimin, përpunimin profesional, huazimin dhe shkëmbimin e materialit bibliotekar;
- 10) merr pjesë në procedurën për restituimin e të mirave materiale që i mban Republika e Maqedonisë;
- 11) jep mendim për plotësimin e kushteve për fillimin, përkatësisht pushimin me punë të bibliotekave nga nenet 8 dhe 10 të këtij ligji;
- 12) përcakton ekzistimin e kushteve për mbrojtjen e veçantë të materialit të huaj bibliotekar kur jepet siguri për ekspozimin e tij si eksponat;
- 13) bën katalogjizimin e publikimeve (CIP regjistrim), ISSN – numër standard ndërkombëtar për revistat dhe ISBN – numër standard ndërkombëtar për libra;
- 14) organizon sistem nacional bibliotekaro-informativ në Republikën e Maqedonisë;
- 15) propozon zbatimin e drejtë të masave teknike-mbrojtëse për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e materialit bibliotekar;
- 16) mban katalogje qendrore të materialit bibliotekar;
- 17) grumbullon, ruan dhe përpunon tekste të disertacioneve të doktoranturës dhe punimeve të magjistraturës dhe bën shkëmbimin e punimeve me botën si qendër nacionale referale;
- 18) ndërmjetëson në shkëmbimin dhe huazimin e materialit bibliotekar ndërmjet bibliotekave në Republikën e Maqedonisë dhe bibliotekave të huaja;
- 19) grumbullon, përpunon dhe ndërmjetëson me të dhëna statistikore dhe të dhëna tjera për punën e bibliotekave;
- 20) përcakton kriteret për çregjistrimin e materialit bibliotekar; dhe
- 21) kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me ligj tjetër.

V. VEPRIMTARIA E BIBLIOTEKAVE

Pasurimi i fondit bibliotekar

Neni 19

(1) Bibliotekat e pasurojnë fondin bibliotekar me blerje, shkëmbim, dhuratë, testamente, nëpërmjet ekzemplarit të obligueshëm të cilin biblioteka të caktuara e marrin në pajtim me ligjin, si dhe nëpërmjet lënies dhe marrjes nga persona tjerë juridikë dhe fizikë.

(2) Organizatat botuese dhe libraritë janë të obliguara që materialin bibliotekar dhe publikimet tjera që i çregjistrojnë, paraprakisht t'ua ofrojnë për shitje bibliotekave në rajonin e njësisë së vetadministrimit lokal ku ato kanë seli ose lokale afariste, me çmim dhe kushte tjera me të cilat u shitet personave për grumbullimin dhe përpunimin e letrës dhe materialit tjetër.

(3) Biblioteka nga paragrafi (2) i këtij neni është e obliguar që në afat prej tridhjetë ditësh ta informojë ofruesin se a e pranon ofertën nga paragrafi (2) i këtij neni. Pas kalimit të afatit, ofertën mund ta pranojë bibliotekë tjetër në të njëjtin afat dhe me të njëjtat kushte.

Ruajtja e fondit bibliotekar

Neni 20

Për shkak të ruajtjes dhe shfrytëzimit të përhershëm të fondit bibliotekar, bibliotekat janë të obliguara ta ruajnë në kushte dhe me zbatimin e mjeteve teknike bashkëkohore, të cilat sigurojnë mbrojtjen e tij të tërësishme dhe efikase.

Evidentimi dhe dokumentacioni i fondit bibliotekar

Neni 21

(1) Bibliotekat janë të obliguara të mbajnë evidencën e fondit bibliotekar dhe të dokumentacionit bibliotekar.

(2) Evidenca e fondit bibliotekar përmban evidencën hyrëse, librin e inventarit, katalogun themelor të fondit bibliotekar dhe lloj tjetër të evidencës.

(3) Bibliotekat lokale në njësitë e vetadministrimit lokal në rajonin e së cilës janë themeluar dhe në të cilat përveç gjuhës maqedonishte dhe alfabetit të saj cirilik, është zyrtare gjuha dhe afabeti të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, evidencën hyrëse dhe katalogut themelor të fondit bibliotekar i mbajnë në gjuhën maqedonishte dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin të cilën e flasin së paku 20% nga qytetarët në Republikën e Maqedonisë në rajonin e asaj njësie të vetadministrimit lokal.

(4) Dokumentacioni bibliotekar përmban të dhëna për të mirat bibliotekare dhe materialet bibliotekare, të cilat nevojiten për përpunimin profesional, identifikimin, mënyrën dhe gjendjen e tyre në të cilën janë furnizuar, ndryshimet e bëra, procesin e përpunimit, etj.

(5) Ministri përshkruan formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës së fondit bibliotekar dhe dokumentacionit bibliotekar nga paragrafi (2) dhe (4) i këtij neni.

Revizioni i fondit bibliotekar

Neni 22

(1) Bibliotekat janë të obliguara të kryejnë revizionin e fondit bibliotekar.

(2) Me revizion përcaktohet gjendja e fondit bibliotekar dhe nevojat për ndërmarrjen e masave përkatëse për mbrojtjen e tij efikase.

(3) Revizioni i fondit bibliotekar kryhet së paku në çdo pesë vjet, kurse për bibliotekën amë së paku në çdo dhjetë vjet.

(4) Bibliotekat mund ta përkufizojnë shfrytëzimin e fondit bibliotekar për shkak të ruajtjes së tij të përhershme.

Çregjistrimi i fondit bibliotekar

Neni 23

(1) Të mirat bibliotekare në bibliotekat publike mund të çregjistrohen nga libri i inventarit në bazë të aktit për ndërprerjen e mbrojtjes, në mënyrë dhe procedurë të përshkruar me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

(2) Çregjistrimi i materialit bibliotekar dhe dokumentacionit bibliotekar bëhet me vendimin, të cilin e merr drejtori i bibliotekës me pëlqimin e marrë paraprakisht nga komisioni profesional, të emëruar nga këshilli drejtues i bibliotekës, sipas kritereve unike.

(3) Kriteret nga paragrafi (2) i këtij neni i përcakton biblioteka amë.

Ekzemplari i domosdoshëm

Neni 24

Mbrojtjen, ruajtjen dhe shfrytëzimin e ekzemplarit të domosdoshëm e realizojnë bibliotekat të përcaktuara me Ligjin për ekzemplarin e domosdoshëm.

Veprimtaria shkencore-arsimore dhe veprimtaria tjetër e bibliotekës

Neni 25

(1) Gjatë kryerjes së veprimtarive të veta themelore, si dhe veprimtarive të lidhura me to, bibliotekat kryejnë punë me interes për shkencën dhe arsimin.

(2) Bibliotekat përhapin njohuri për vlerat dhe rëndësinë e vlerave kulturore dhe shkencore të bibliotekave.

(3) Bibliotekat përgatisin dhe realizojnë programe arsimore interaktive, të orientuara me përparësi ndaj fëmijëve, nxënësve dhe studentëve.

(4) Bibliotekat janë të obliguara t'u mundësojnë vizitorëve shfrytëzimin e materialit bibliotekar, si dhe prezentimin e qartë të materialeve të ekspozuara bibliotekare, nëpërmjet vendosjes së mbishkrimeve, shenjave, botimit të udhërfyesve dhe ngjashëm.

(5) Bibliotekat mund të kryejnë edhe veprimtari tjera, të cilat janë në funksion të vizitueshmërisë më të mirë dhe prezentimit komercial dhe marketingut të shërbimeve bibliotekare, siç është hapja e kefitërive, librarive, shitja e materialit informativ dhe ngjashëm me kushtet e përcaktuara me ligji.

Prezentimi i fondit bibliotekar

Neni 26

(1) Bibliotekat kryejnë prezentimin e fondit bibliotekar nëpërmjet organizimit të ekspozitave të përhershme dhe të kohëpaskohshme, si dhe nëpërmjet sigurimit të informatave plotësuese për veprimtarinë e tyre.

(2) Prezentimet organizohen në bazë të parimeve shkencore dhe në mënyrë e cila mundëson njohjen e vlerës kulturore dhe shkencore të fondit të ekspozuar bibliotekar.

(3) Prezentimi i fondit bibliotekar kryhet në kushte dhe në mënyrë me të cilën garantohet siguri i plotë i fondit të ekspozuar bibliotekar.

Koha e punës e bibliotekave

Neni 27

(1) Koha e punës së bibliotekave duhet të organizohet në mënyrë, e cila mundëson shfrytëzimin e të gjitha grupeve qëllimore të shfrytëzuesve.

(2) Bibliotekat janë të obliguara t'i shpallin publikisht ditët dhe orët për punë.

(3) Fëmijët, nxënësit dhe studentët, si dhe personat me nevoja të posaçme paguajnë çmime të zvogëluara të shërbimeve ose lirohen nga pagesa e tyre.

(4) Çështjet nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni rregullohen për së afërmi me statutin e bibliotekës.

Përpunimi i ekzemplarëve të materialit bibliotekar

Neni 28

Materialet bibliotekare mund të riprodhohen në ekzemplarë bibliotekarë me qëllim jokomercial, në pajtim me dispozitat për të drejtën e autorit dhe të drejtave të ngjashme.

Kopjet e të mirës bibliotekare

Neni 29

(1) Kopje të së mirës bibliotekare përpunohet për shkak të ruajtjes së saj në rastet:

1) kur kjo është e nevojshme për shkaqet e sigurisë;

2) kur nuk ekzistojnë kushte përkatëse për ruajtjen e saj;

3) kur e mira bibliotekare i është dhënë për shfrytëzim të përkohshëm një biblioteke tjetër ose institucioni tjetër të ngjashëm; dhe

4) kur ekziston nevoja e domosdoshme për ekspozimin e saj në një bibliotekë tjetër.

(2) Për një të mirë bibliotekare nuk mund të përpunohen më shumë se tri kopje. Për çdo kopje të së mirës bibliotekare, biblioteka jep vërtetetim.

(3) Në biblioteka mbahet regjistër i kopjeve të së mirave bibliotekare.

(4) Përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të kopjeve bibliotekare nga paragrafi (3) i këtij neni dhe formularin e vërtetimit nga paragrafi (2) i këtij neni, i përshkruan ministri.

Shfrytëzimi i të mirës bibliotekare për qëllime komerciale

Neni 30

Prodhimi i mallrave, etiketave dhe zgjidhjeve të dizejnit, në të cilat përmbahen fotografi ose pasqyrë grafike të së mirës bibliotekare, me lejen paraprakisht të marrë nga bartësit e të drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjajshme, kryhet në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Sigurimi i fondeve bibliotekare

Neni 31

Fondet bibliotekare të bibliotekave publike, dokumentacioni bibliotekar dhe lokali në të cilin është vendosur biblioteka, detyrimisht sigurohen të shoqata siguruese me mjetet që i siguron themeluesi.

VI. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E SHFRYTËZUESVE

Të drejtat e shfrytëzuesve

Neni 32

(1) Shfrytëzuesit e bibliotekave kanë të drejtë të shërbimeve themelore bibliotekare për shfrytëzimin e fondeve bibliotekare, shfrytëzimin e informatave për fondin dhe udhëzimet për shfrytëzimin e burimeve të informatave.

(2) Të drejtat e shfrytëzuesve rregullohen më afër me akte të veçanta të bibliotekave.

Grumbullimi dhe mbrojtja e të dhënave personale të shfrytëzuesve

Neni 33

Në funksion të veprimtarisë së vet, kurse në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, bibliotekat i marrin të njëjtat nga shfrytëzuesit e vet dhe janë të obliguar t'i shfrytëzojnë vetëm për destinimin për të cilin janë marrë.

Obligime të shfrytëzuesve

Neni 34

(1) Shfrytëzuesit e shërbimeve bibliotekare kanë obligim t'i respektojnë rregullat për shfrytëzimin e shërbimeve bibliotekare në pajtim me këtë ligj, ligj tjetër, akt të përgjithshëm dhe me akt tjetër të bibliotekave.

(2) Bibliotekat janë të obliguara t'ua kumtojnë shfrytëzuesve rregullat për të drejtat dhe obligimet e tyre në mënyrë përkatëse dhe transparente.

VII. SIGURIMI I EKSPONATEVE DHE EKSPOZITAVE NGA BOTA

Sigurimi

Neni 35

Sigurimi në kuptimin e këtij ligji është garancia e Republikës së Maqedonisë për kompensimin e dëmit të ekspozitave dhe ekspozitave nga bota, të bëra me marrëveshje përkatësisht të organizuara në territorin e Republikës së Maqedonisë, nga ana e bibliotekave publike.

Kushte për dhënien e sigurimit

Neni 36

(1) Sigurimi në kuptim të nenit 35 të këtij ligji mund të jepet për:

1) ekspozate përkatësisht ekspozita nga bota, të cilat kanë vlerë të veçantë kulturore artistike, shkencore dhe historike, nëse prezentimi i tyre është kushtëzuar me sigurimin paraprak të sigurimit;

2) ekspozatat përkatësisht ekspozitat për të cilat shpenzimet e sigurimit të shoqata siguruese janë ekskluzivisht të larta për shkak të vlerës së deklaruar të ekspozateve, kurse pronari pajtohet të pranojë mënyrën e tillë të sigurimit;

(2) Sigurimi nuk mund të jepet për ekspozate dhe ekspozita të ndërmarra, përkatësisht të organizuara me qëllime komerciale.

Vendimi për dhënien e sigurimit

Neni 37

(1) Vendim për dhënien e sigurimit në kuptim të nenit 36 të këtij ligji merr Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozimin e Ministrisë.

(2) Vendimi nga paragrafi (1) i këtij neni mund të merret nëse biblioteka publike-organizatore e ekspozitës, siguron kushte të veçanta për mbrojtjen e ekspozateve, veçanërisht siç janë:

1) mbrojtja e pandërprerë fizike e ekspozateve nga momenti i marrjes deri në momentin e dorëzimit;

2) mbajtja e kushteve klimatike dhe kushteve tjera sipas llojit të ekspozatit;

3) sigurimi i objekteve dhe lokaleve nga të gjitha llojet e rrezikut, të cilat mund ta rrezikojnë sigurinë e ekspozateve.

(3) Sigurimin e kushteve nga paragrafi (2) të këtij neni i përcakton biblioteka amë.

VIII. SISTEMI NACIONAL BIBLIOTEKAR-INFORMATIV

Uniteti i sistemit bibliotekar-informativ

Neni 38

(1) Bibliotekat në Republikën e Maqedonisë veprojnë si sistem unik nacional bibliotekar-informativ, i cili funksionon si bazë unike interaktive nacionale bibliografike-katalogjike e të dhënave, e cila ndërlidhet me sistemet tjera bibliotekare-informative në botë (në tekstin e mëtejshëm: sistemi bibliotekar-informativ).

(2) Nëpërmjet sistemit bibliotekar-informativ sigurohet puna bibliotekare e harmonizuar, standardizuar dhe e ekonomizuar, shfrytëzimi racional i materialit bibliotekar dhe kënaqja e nevojave me informata.

(3) Sistemin bibliotekar-informativ të Republikës së Maqedonisë e përbëjnë nënsisteme, numrin, llojin dhe funksionimin e të cilave e përcakton dhe mirëmban biblioteka amë. Biblioteka amë është selia e bazës nacionale interaktive bibliografike-katalogjike e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni.

Ndëlidhja me sistemin informatave shkencore

Neni 39

Bibliotekat nëpërmjet bashkëpunimit me shërbimet informative-dokumentare dhe qendrat informatike të institucioneve shkencore-hulumtuese, ndërlidhen me sistemin e informatave shkencore.

Uniteti i sistemit bibliotekar-informativ

Neni 40

Uniteti i sistemit bibliotekar-informativ sigurohet veçanërisht nëpërmjet:

- përpunimit unik profesional të materialit bibliotekar;
- mënyrës unike të grumbullimit dhe përpunimit të informatave dhe të dhënave;
- mbajtjes unike të katalogjeve dhe mjeteve tjera ndihmëse informative dhe sigurimit unik të veprimit të katalogjeve qendrore; dhe
- zhvillimit të bashkëpunimit ndërbibliotekar dhe huazimit të materialit bibliotekar.

Të drejtat dhe obligimet e subjekteve të sistemit bibliotekar-informativ

Neni 41

Të drejtat dhe obligimet e subjekteve të sistemit bibliotekar-informativ më afër rregullohen me marrëveshje.

IX. KËSHILLI NACIONAL PËR BIBLIOTEKARI

Këshilli nacional për bibliotekari

Neni 42

(1) Për shkak të analizës së gjendjes, përcaktimit të masave për përparimin dhe zhvillimin afatgjatë në realizimin e veprimtarisë së bibliotekave, themelohet Këshilli nacional për bibliotekari si trup këshilldhënës dhe profesional i ministrit (në tekstin e mëtejme: Këshilli).

(2) Këshilli përbëhet nga kryetari dhe tetë anëtarë, të cilët i emëron dhe shkarkon ministri.

(3) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit emërohen nga radhët e individëve të dalluar nga lëmi i bibliotekarisë, shkencës, kulturës, arsimit, si dhe nga shoqatat e qytetarëve nga ky lëm.

(4) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit emërohen për një periudhë prej katër vjetësh dhe serish mund të zgjedhen.

Kompetenca e Këshillit

Neni 43

Këshilli:

- 1) shqyrton çështjet e përgjithshme lidhur me realizimin e veprimtarisë bibliotekare;
- 2) përcjell dhe analizon të arriturat dhe gjendjen në veprimtarinë bibliotekare;
- 3) jep mendime dhe propozime për dispozitat dhe strategjinë për zhvillimin dhe përparimin e mëtejshëm të veprimtarisë bibliotekare;
- 4) diskuton për çështjet kontestuese lidhur me veprimtarinë bibliotekare dhe jep mendim për zgjidhjen e tyre;
- 5) studion dhe jep mendim për organizimin e rrjetit bibliotekar në Republikën e Maqedonisë;
- 6) miraton rregullore për punën e vet; dhe
- 7) kryen punë tjera të përcaktuara me ligj.

Punë administrative-teknike

Neni 44

Punët administrative dhe teknike për Këshillin i kryejnë të punësuarit në Ministri.

X. TITUJT PROFESIONALË

Kryerja e punëve profesionale në biblioteka

Neni 45

Në biblioteka punët profesionale i kryejnë punëtorët me tituj shkencorë zgjedhorë, me tituj shkencorë jozgjedhorë dhe punëtorë me tituj tjerë profesionalë dhe shkencorë.

Tituj profesionalë zgjedhorë

Neni 46

Punët profesionale në biblioteka i kryejnë punëtorët me tituj zgjedhorë bibliotekar i lartë dhe bibliotekar këshilltar.

Kushte të veçanta për zgjedhje në bibliotekar i lartë dhe bibliotekar këshilltar

Neni 47

(1) Në titull bibliotekar i lartë mund të zgjedhet personi i cili ka:

1) kryer studimet e magjistraturës nga lëmi përkatës dhe tri vjet punë si bibliotekar ose dhjetë vjet pune si bibliotekar;

2) projekte profesionale të botuara dhe të realizuara me rëndësi për përparimin e veprimtarisë bibliotekare; dhe

3) aftësi për organizimin e pavarur të punës profesionale.

(2) Në titull bibliotekar-këshilltar mund të zgjedhet personi i cili ka:

1) kryer studimet e magjistraturës nga lëmi përkatës dhe tri vjet punë si bibliotekar i lartë ose dhjetë vjet pune si bibliotekar i lartë;

2) projekte profesionale të dalluara të botura dhe të realizuara me rëndësi të veçantë për përparimin e veprimtarisë bibliotekare nga lëmi më i ngushtë për të cilin zgjedhet; dhe

3) shkallë të lartë pavarësie në organizimin e punës profesionale.

(3) Personat e zgjedhur në tituj nga paragrafi (1) paragrafi (2) i këtij neni, pas rizgjedhjes së parë nuk rizgjedhet.

Kompetenca dhe procedura për zgjedhje dhe rizgjedhje në titull profesional

Neni 48

(1) Zgjedhjen dhe rizgjedhjen në tituj profesionalë nga nenet 46 dhe 47 të këtij ligji e bën ministri, në pajtim me Ligjin për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, në bazë të vlerësimit të komisionit për recenzim.

(2) Procedura për zgjedhje dhe rizgjedhje në titull profesional zhvillohet me kërkesën e punëtorit të interesuar profesional. Procedura për rizgjedhje mund të zhvillohet edhe me iniciativën e drejtorit të bibliotekës publike ose nga ana e organit të administrimit të bibliotekës publike, më së voni në afat prej tre muajsh para kalimit të afatit për rizgjedhje.

(3) Komisioni për recenzim nga paragrafi (1) i këtij ligji përbëhet prej së paku tre anëtarësh, të zgjedhur nga radhët e personave, të cilët kanë së paku titull të njëjtë për të cilin bëhet zgjedhja, përkatësisht rizgjedhja ose kanë titull përkatës shkencor. Më shumë se gjysmën e anëtarëve të komisionit e përbëjnë personat nga lëmi i njëjtë profesional në të cilin zgjedhet kandidati.

(4) Komisioni i recenzimit paraqet raport me shkrim në afatin e përcaktuar me aktin për formimin e tij.

(5) Raporti nga paragrafi (4) i këtij neni përmban të dhëna biografike për kandidatin, pasqyrën dhe vlerësimin e punës së tij profesionale dhe vlerësimin për plotësimin e kushteve për rizgjedhje.

(6) Procedura për zgjedhje dhe rizgjedhje në titull profesional më së shumti zgjat tre muaj.

Tituj joprofesionalë zgjedhorë

Neni 49

Punët profesionale në bibliotekë i kryejnë punëtorë me tituj profesionalë jozgjedhorë, të cilët kanë arsimimin e mesëm përkatës për titullin ndihmës bibliotekar dhe arsimimin e lartë përkatës për titullin ndihmës i pavarur bibliotekar dhe arsimimin përkatës sipëror për titullin bibliotekar, në pajtim me aktet e bibliotekës.

Kryerja e punëve tjera profesionale në veprimtarinë bibliotekare

Neni 50

Punë të caktuara në lëmin e veprimtarisë bibliotekare mund të kryejnë edhe punëtorë, të cilët kanë tituj shkencorë, si tituj profesionalë në lëmin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, punën arkivore dhe veprimtarinë muzeore dhe punëtorë tjerë në pajtim me aktin e përgjithshëm të bibliotekës.

XI. MBIKËQYRJA

Kryerja e mbikëqyrjes

Neni 51

- (1) Mbikëqyrjen në zbatimin e këtij ligji e bën Ministria.
- (2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes në punën e organeve të komunës, Ministria i bën punët vijuese:
 - 1) përcjell ligjshmërinë e punës së organeve të komunës dhe ndërmerr masa dhe aktivitete dhe paraqet iniciativa për realizimin e kompetencave të komunës në pajtim me këtë ligj;
 - 2) vlerëson se a sigurojnë organet e komunës që kompetencat e komunës të realizohen në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara me këtë ligj;
 - 3) jep rekomandime për zbatimin konsekuent të kompetencave të komunës në kuadrin e përcaktuar me këtë ligj, me kërkesën e organeve të komunës;
 - 4) përcjell ligjshmërinë e vendimeve të cilat i merr prefekti në zgjidhjen e të drejtave individuale gjatë zgjedhjes së drejtorit të biblioteksës, dhe
 - 5) i lajmëron me kohë organet e komunës për gjendjen e konstatuar në punën e tyre dhe për masat e ndërmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.
- (3) Mbikëqyrjen inspektuese të zbatimit të këtij ligji e kryen Ministria nëpërmjet inspektorëve për kulturë në pajtim me Ligjin për kulturë dhe Drejtorinë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

XII. DISPOZITA NDËSHKIMORE

Kundërvajtje

Neni 52

- (1) Me dënim me para prej 100. 000 denarë deri 200. 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:
 - 1) fillon të kryejë veprimtari bibliotekare pa vendim se i plotëson kushtet e veçanta për fillimin me punë për kryerjen e veprimtarisë (neni 8);
 - 2) nuk mban evidencë hyrjeje, libër inventari, katalog themelor të materialit bibliotekar dhe të dokumentacionit bibliotekar dhe lloji tjetër të evidencës dhe dokumentacionit (neni 21);
 - 3) nuk kryen revizionin e fondit bibliotekar (neni 22);
 - 4) publikisht nuk i shpall ditët dhe orët për vizitë dhe nuk përcakton çmime të zvogëluara për llojin e përcaktuar të vizitorëve, përkatësish nuk i liron nga pagesa e shërbimeve (neni 27 paragrafi (2) dhe (3));
 - 5) për një të mirë bibliotekare përpunon më shumë se tre ekzemplarë (neni 29 paragrafi 2); dhe
 - 6) nuk mban regjistrin e kopjeve të së mirave bibliotekare (neni 29 paragrafi 3);
- (2) Me dënim me para prej 10. 000 deri 30. 000 denarë do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personi përgjegjës në personin juridik.
- (3) Me dënim me para prej 10. 000 deri 50 .000 denarë do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe tregtari-individ.
- (4) Për kundërvajtje nga paragrafi (1) pika 5 e këtij neni, personit juridik mund t'i shqiptohet masa e sigurisë marrje e lëndëve, të cilat janë gjendur me kryerjen e kundërvajtjes.

XIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 53

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bibliotekat amë të themeluara në pajtim me Ligjin për veprimtarinë bibliotekare ("Gazeta zyrtare e RSM-së" nr. 17/74, 42/76, 17/84 dhe 51/88 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/93) vazhdojnë të punojnë si biblioteka publike, të lemeluara në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për kulturë.

Themelimi i Këshillit

Neni 54

Këshilli do të themelohet në afat prej 30 ditësh nga dita e zbatimit të këtij ligji.

Akte nënligjore

Neni 55

(1) Dispozitat, nxjerrja e të cilave është paraparë me këtë ligj, do të nxirren më së voni në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të aktit të përgjithshëm nga neni 2 paragrafi (2) i këtij ligji, do të zbatohet Rregullorja për përcaktimin e materialit bibliotekar, që do të konsiderohet si përmendore e kulturës dhe material i rrallë bibliotekar dhe për kushtet dhe mënyrën e përpunimit të tij profesional, mbrojtje, ruajtje dhe shfrytëzim ("Gazeta zyrtare e RSM-së" nr.8/78).

Tituj profesionalë

Neni 56

Personave të cilët deri në zbatimin e këtij ligji kanë marrë tituj bibliotekar i lartë dhe bibliotekar-këshilltar, në pajtim me Ligjin për veprimtarinë bibliotekare ("Gazeta zyrtare e RSM-së" nr. 17/74, 42/76, 17/84 dhe 51/88 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/93), u pranohen titujt e fituar.

Riemërtimi i bibliotekës amë

Neni 57

Biblioteka e deritashme "Shën Kliment Ohridski" – Shkup, me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdon të punojë si Institucion nacional "Biblioteka nacionale dhe univerzitare "Shën Kliment Ohridski" – Shkup".

Pushimi i ligjit ekzistues

Neni 58

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji për veprimtarinë bibliotekare ("Gazeta zyrtare e RSM-së" nr. 17/74, 42/76, 17/84 dhe 51/88 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/93).

Hyrja në fuqi e Ligjit dhe fillimi i zbatimit të Ligjit

Neni 59

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet nga dita e konstituimit të këshillave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe zgjedhjes së prefektëve të komunave dhe prefektit të Qytetit të Shkupit pas zbatimit të zgjedhjeve të para të ardhshme lokale në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 46/96, 12/2003, 35/2004, 52/2004 dhe 60/2004).